



Në bazë të dispozitave të nenit 4.1 dhe nenit 39.1 të Rregullores së UNMK-ut, nr 2000/45, të dispozitave të nenit 19 (i), nenit 40 (d) dhe të nenit 86 të Statutit të Komunës së Prishtinës të dt 16.03.2001, të dispozitave të Rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale 01. nr. 413-523, të dt. 02.04.2002, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2005 miratoi

RREGULLOREN PËR LEJE PUNE TË SHOQËRIVE TREGTARE (TEKST I SPASTRUAR)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet për dhënien e lejes për punë shoqërive tregtare për ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë në tregun e brendshëm (tregtisë me shumicë, tregtisë me pakicë), hotelierisë, ndërtimtarisë, zejtarisë, masat mbikëqyrëse, sanksionet administrative dhe dispozitat përfundimtare.

Përkufizime

Neni 2

Termet e dhëna në këtë Rregullore do të kenë këtë kuptim:

- **“Shoqëri tregtare”**, do të thotë çdo person apo grup personash që merren me aktivitete tregtare, ekonomike, e të cilët janë të mbështetura në ligj, dhe akte tjera normative, e më qëllim përfitimi;
- **“Person fizik”**, nënkupton individin ose personin fizik si pronar të ndërrmarjes së regjistruar si biznes individual;
- **“Person juridik”**, nënkupton shoqërinë aksionare, partneriteti (shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe komandite), kompaninë e huaj, ndërrmarrjen shoqërore dhe ndërrmarrjen publike;
- **“Drejtorat”** nënkupton Drejtoratin e Ekonomisë të Komunës së Prishtinës, i themeluar me skemën organizative për organet e administrates komunale;
- **“Leje e punës”**, nënkupton lejen e lëshuar nga organi kompetent, në pajtim me kushtet e përcaktuar me ligj dhe më këtë rregullore, në bazë të të cilave ushtrohet biznesi i caktuar;
- **“Lokal afarist”**, lokali i përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë afariste, si dhe lokalin tjetër të paraprë për një veprimtari të tillë,

- “**MTI**”- Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë.
- “**Mbikëqyrje inspektuese**” – mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, të akteve tjera nënligjore, si dhe marrja e masave administrative dhe masave të tjera më qëllim që parregullsitë e konstatuara gjatë inspektimit të menjanohen siapas ligjit;
- “**Inspektor**” – personi zyrtar, me autorizim dhe përgjegjësi të vacantë i cili zbaton mbikëqyrjen inspektuese të afarizmit të personave fizikë apo juridikë.

Neni 3

3.1 Të gjitha aktivitetet afariste në komunën e Prishtinës duhet të kryhen në vend të caktuar dhe të përshtatshëm, e të cilat i plotësojnë kushtet minimale tekniko-sanitare.

3.2 Sipas kësaj Rregulloreje asnjë subjekt afarist, nuk lejohet të ushtrojë veprimtarinë afariste pa leje pune të leshuar nga Drejtorati.

Neni 4

4.1 Shoqëria tregtare që ushtron veprimtarinë në komunën e Prishtinës, duhet të jetë e regjistruar sipas Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/6 për shoqëritë tregtare dhe në bazë të urdhëresave dhe udhëzimeve të tjera të leshuara nga IPVQ-të dhe Komuna e Prishtinës.

4.2 Shoqëria tregtare që ushtron veprimtarinë biznesore brenda komunës së Prishtinës duhet:

- të ketë lejen e punës për ushtrimin e biznesit për secilen njësi,
- t'i përmbahet lejës së punës e cila ka karakter personal dhe nuk mund të bartët në personin e tretë, përveç rasteve kur kjo është e lejuar me ligj.

Neni 5

Shoqëria tregtare, për të marrë lejen e punës, kërkesës duhet t'i bashkëngjese:

5.1 Certifikatën e regjistrimit të biznesit pranë MTI-së, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/6, urdhëresat dhe udhëzimet tjera,

5.2 Lejen e ndërtimit.

Shoqëritë tregtare, të cilat nuk posedojnë lejen e ndërtimit apo lejen e shndërrimit nga lokali banesor në atë afarist, në të cilin e ushtrojnë veprimtarinë, iu jepet leja e punës, me kusht që brenda një viti të sigurojë lejen përkatëse. Nëse edhe pas skadimit të këtij afati nuk e siguron lejen përkatëse, e njehta nuk do të vazhdohet.

5.3 Provën më të cilën shoqëria e dëshmon pronësinë e lokalit afarist, ose kontratën për marrje me qira të lokalit afarist të vërtetuar nga Gjykata kompetente.

5.4 Pëlqimin e dhenë nga komisioni për pranimin e kushteve minimale teknike – sanitare për lokale afariste pranë Drejtoratit të Inspekcionit.

5.5 Provën për pagesën e tarifës komunale për lëshimin e lejes së punës, sipas Rregullorës për tarifat dhe ngarkesat komunale 01. nr. 413-523, të dt. 02.04.2002,

5.6 Fotokopjen e lejes së njoftimit.

5.7 Skica e lokalit me sipërfaqe të përgjithshme.

Neni 6

Drejtorati është i obliguar që brenda afatit prej 15 ditësh, ushtruesit të kërkesës t'i jep përgjigje me shkrim për aprovimin apo refuzimin e kërkesës për leje pune.

Neni 7

7.1 Leja e punës është e përhershme, përveç nëse me ligj të veçantë është paraparë ndryshe.

7.2 Nëse përkundër plotësimit të kushteve, pronarit nuk i lëshohet leja nga organi kompetent komunal, inspektori i MTI-së mund të urdhërojë dhënien e lejes për punë

7.3 Në rast kur edhe pas urdhërit të inspektorit të MTI-së, nuk i lëshohet leja e punës, ky i fundit lëshon lejen e vlefshme të punës.

Neni 8

8.1 Leja e punës do të ndryshojë nëse shoqëria tregtare ndryshon adresën, bëhet ndërrimi i pronarit apo ndërrohet veprimtaria.

8.2 Afati për ndryshimin e lejes për rastet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, është 3 ditë nga dita e ndryshimeve që janë bërë në çertifikatën dhe informacionin e saj.

Neni 9

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë pronari është i obliguar që në lokalin afarist, në vend të caktuar të vendosë certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe lejen për punë, si dhe ta mbajë evidencën lidhur me blerjen, shitjen dhe çmimet e mallit.

II. MASAT MBIKËQYRËSE

Neni 10

Mbikëqyrjen në implementimin e dispozitave të këtij ligji e ushtron Inspekcioni i tregut pranë Drejtoratit të Inspekcionit.

Neni 11

11.1 Nëse inspektori i tregut konstaton se aktiviteti afarist nuk është i regjistruar apo nuk posedon leje pune, ai/ajo mund të ndalojë përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë afariste, deri në eliminimin e këtyre parregullësive.

11.2 Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

Neni 12

12.1 Nëse inspektori gjatë inspektimit zbulon parregullsi, kurse veprimtaria me shumicë nuk ushtrohet në objektet përkatëse apo depo, ose malli i caktuar blehet në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me vendim, mund t'i ndalohet përkohësisht ushtrimi i veprimtarisë afariste, deri në eliminimin e parregullësive,

12.2 Ankesa në vendim nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Neni 13

13.1 Ankesa kundër vendimit të inspektorit të tregut, i drejtohet Inspektoratit të MTI-së në afat prej 15 ditësh nga data e marrjes së vendimit të inspektorit.

13.2 Vendimi i Inspektoratit të MTI-së merret brenda 60 ditëve nga data e pranimin të ankesës, dhe i njetëi mund të apelohe pranë gjykatë përkatëse.

III.SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 14

Personi fizik apo juridik gjobitet në shumë prej **3000 €** deri me **9000 €** nëse:

- a.** ushtron veprimtarinë për të cilin nuk është regjistruar, neni 4.1,
- b.** ushtron veprimtari pa leje pune në kundërshtim me nenin 3.2,
- c.** zhvillon veprimtari që nuk i përmbush kushtet minimale teknike apo sanitare dhe shëndetësore të përcaktuara sipas nenit 3.1,
- d.** nuk i mban librat e evidencave ashtu siç është parapar me nenin 9.

Neni 15

Personi fizik dhe juridik Gjobitet prej **2000 €** deri **6000 €**

nëse shet mallra në ambient të hapur dhe nuk është i regjistruar pranë MTI-së, respektivisht nuk ka leje për ushtrimin e veprimtarisë ose për shitjen e mallrave, të cilat sipas dispozitave të veçanta nuk mund të shiten në ambient të hapur, neni 3.1, 4.1, 3.2.

Neni 16

16.1 Procedurën për shkelje e udhëheq Gjykat Komunale për kundërvajtje në Prishtinë.

16.2 Procedurat, udhëheqja e së cilave nuk ka përfunduar, procesohen sipas dispozitave të cilat kanë qenë në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Me hyrje në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon së vlejtori Rregullorja për leje pune të subjekteve afariste 01. nr. 360 -1597, dt. 22.08.2002 dhe Vendimi për ndryshim dhe plotësim i Rregullores për leje pune të subjekteve afariste 01. nr. 330-1696, i dt. 02.10.2003.

Neni 18

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. NR. _____, më _____

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri